



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 05 shkurt 2019, në mbledhjen e VIII-të (tetë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.40.

Mbledhjen e hapi dhe deri në zgjedhjen e Kryesuesit e kryesoi Valbona Kadriu Podvorica, Zëvendës kryesuese e Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, Albina Avdiu, Xhafer Ademi, Bashkim Sylja, Mefail Rama ndërsa mungoi Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Bashkim Bajrami nga Policia Kufitare, Fadil Babatinca nga Stacioni Policor në Podujevë, Skender Shatri dhe Bekim Karaxhija përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të UNMIK dhe përfaqësues të KFOR - LMT.

Miratimi i rendit të ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, i njoftoi rreth pikave të rendit të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 09.01.2019

Njëzëri u miratua Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 09.01.2019

2. Draft Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e prezantoi propozim planin e punës së komitetit për vitin 2019, fjalën ja dha anëtarit të grupit punues z.Benjamin Ejupi.

z.Benjamin Ejupi, e paraqiti propozim Plani e punës së komitetit për vitin 2019, ndër të tjera theksoi, në pika të shkurtra deshta të them se kemi qenë pjesë e planit që e kemi bërë edhe për këtë vite edhe për vitin e kaluar. Jemi mbështet kryesisht në planin e vitit të kaluar që e kemi pas dhe në këtë plan përfshihen zakonisht detyrat e përhershme siç janë implementimi i strategjisë së Qeveris së Republikës së Kosovës, për integrimin e komuniteteve Rom dhe Ashkali, mbikëqyrja e drejtpërdrejt e në realizimin e plotë të të drejtave, lirive dhe interesave të bashkësive etnike që jetojnë në territorin e Komunës së Podujevës, angazhimi në ruajtjen dhe mbrojtjen e entiteteve dhe

vlerave etnike kulturore pavarësisht nga përkatësia etnike, avancimi i marrëdhënieve të mira ndëretnike, rekomandimet e masave të organeve përkatëse për qështje të cilat gjatë punës dhe aktiviteteve vlerëson se janë të nevojshme në realizimin e plot të të drejtave të parapara ligjore si dhe dispozitave të konventave ndërkombëtare. Në planë ne i kemi paraparë edhe disa vizita ti bëjmë gjatë këtij viti 2019-të. Njërin prej vizitave e kemi paraparë ta bëjmë në rrugën “Xhafer Meta” në muajin qershor të vitit 2019, vizitën e komunitetit pakicë në rrugën “Ali Ajeti” gjithashtu në muajin qershor, vizitë të komuniteteve pakicë në shkollat fillore në fshatrat Batllav dhe Orllan në qershor, informata për përfundimin e fitit shkollor 2018-2019 me theks të veçantë vijueshmëria e shkollimit të komunitetit Ashkali dhe rom në vitin 2018-2019 pasi që të përfundon mësimi. Gjithashtu, në korrik në javën e parë kemi planifikuar të identifikojmë personat e komunitetit pakicë të cilët e kanë ndërprerë shkollimin e mesëm dhe ndërmarrja veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimorë jo formal dhe përfundimin e klasave përkatëse. Informata për fillimin e vitit shkollor gjithashtu përkon me muajin shtator dhe me fillimin e vitit të ri shkollor. Vizita e komunitetit pakicë në shkollën fillore në Orllan në shtator, vizitë në shkollën e mesme të ulët “Sami Frashëri” dhe “Shaban Shala” në tetor. Shikimi i mundësive për gjetjen e donatorëve për sigurimin e lendeve djegëse gjatë dimrit të familjeve me nevojë të komunitetit pakicë në tetor e për këtë kemi pas një mbledhje edhe vitin e kaluar për këtë pikë të rendit të ditës. Gjithashtu, kemi vizita edhe të komuniteteve të komunave tjera e që kemi pas disa propozime por e kemi pa të arsyeshme që prej të gjitha komunave që i kemi pas si propozime kemi vendos që në komunën e Prizrenit dhe në komunën e Mitrovicës të shkojmë dhe të takohemi me komunitetin për komunitete. Mendoj që ky plan është goxha i kompletuar, gjatë punës mundet të shtohet ose të hiqet ndonjë pikë e këtij plani mirëpo në përgjithësi kisha deshtë që ky plan në përpikëri të implementohet gjatë vitit 2019.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, sa i përket planit është i përgatitur mirë, por i njëjti mund të ndryshoj, në kuptimin e asaj që mund të ndryshohet edhe koha, data edhe vizitat e parapara, varet prej komunitetit për komunitete çfarë i përshtatet. Do të ishte mirë që në disa pika ku ceken komunitetet ashkalinj dhe rom të përfshihet edhe komuniteti egjiptas për faktin që ne kemi një situatë më ndryshe sepse ne kemi edhe komunitetin egjiptas e që janë dy familje, prandaj është mirë të përmirësohet dhe të bëhet Ashkali, Rom dhe Egjiptas. Këtyre familjeve të komunitet Egjiptas ju është ndërtua edhe një shtëpi dhe me vetë dëshirë janë deklaruar se i përkasin këtij komuniteti dhe në shenjë respekti dua që të futet edhe ky komunitet në renditje.

Pas votimit njëzëri u miratua Plani i Punës së komitetit për Komunitete për vitin 2019, me plotësim përkatësisht atë ku theksohen komunitetet jo shumicë Rom dhe Ashkalinj të përfshihet edhe komuniteti Egjiptas .

3. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, njoftoj, unë do të japë dorëheqje të parevokueshme nga Komiteti për Komunitete, me arsyetimin se e kamë bashkëshorten të sëmur nga kanceri dhe nuk mundem të vij në komunitet. Jam në dispozicion që çdo kush që ka nevojë për ndonjë shënim që nevojitet prej meje unë do ti jap, edhe informatat që duhen do të konsultohem sidomos me z.Liman Zeqirin edhe shumë të tjerë prandaj, do të ju lus që arsyeja ime të merret parasysh sepse kamë nevojë familjare. Me keqardhje po ju them se jap dorëheqje vullnetare dhe ju lus të më përkradni.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, janë disa çështje ligjore dhe procedurale por edhe çështje të ndjeshme që ne nuk jemi ata që marrim vendim dhe çdo anëtar i Komitetit për Komunitete është i barabartë. Ne edhe në mbledhjen e kaluar kemi pas temën që kemi shpreh mirënjohje dhe falënderim për të ndjerin Shaban Ahmeti por jeta është e tillë dhe proceset vazhdojnë, por pas proceseve që janë bërë është deshtë që dikush ta zëvendësoj. Ka qenë një thirrje publike që është dashtë të mblidhen nënshkrime për të qenë i pranueshëm nga komuniteti dhe është e drejtë legjitime të konkurrojnë njerëzit por të jenë të përgatitur, të jenë aktiv dhe të kenë bagazh të përvojës. Njëri prej tyre që keni konkurruar jeni ju (Xhafer Ademi) i cili keni mbledhur nënshkrime dhe jeni përkrahur. Unë jam mirënjohës, po flas në emër timin por edhe të anëtarëve që janë këtu duke u bazuar në aktivitetin tënd të punëve dhe për bashkëpunimin e jashtëzakonshëm për t'i avancuar komunitetin pakicë dhe ka qenë mënyra më e përshtatshme edhe në kuptimin e religjionit apo vendbanimeve për të qenë më afër komunitetit. Unë e mora si shqetësuese këtë dorëheqjen tënde për shkak të procedurave ligjore se tani si do të mbërrijmë deri tek zgjedhja e një kryesuesi të ri të Komitetit. Ne jemi të gatshëm që të ju ndihmojmë të gjithë së bashku lidhur me shëndetin e bashkëshortes tënde vetëm ju të mos largoheni sepse do të marrë kohë deri te zgjedhja e një kryesuesi të ri.

z.Bashkim Syla, theksoi, do të lutesha që ka mundësi z.Xhafer Ademi ta shqyrtoj si mundësi mos dorëheqjen deri tek mbledhja e ardhshme pasi që jështë në të mirë edhe të komunitetit, ne do të shqyrtojmë mundësinë për të ndihmuar. Andaj sërish ju lus që deri në mbledhjen e ardhshme ta shikosh mundësin e tërheqjes së dorëheqjes ngase kjo është veç për të mirë të komunitetit.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë po i kuptoj të gjitha dhe nuk jam prej atyre që nuk i njoh gjërat më larg dhe që nuk i di sepse kam qenë prej fillimit anëtar i Komitetit për Komunitete, përveç këtij mandati për shkak se është deshtë të bëhet barazia gjinore, e që me dëshirë jam tërheqë, por rrethanat janë kështu, dhe për të mirën e familjes time unë tërhiqem edhe tani.

z.Mefail Rama, theksoi, unë kisha pasë një pyetje për kryesuesin Xhafer Ademi sepse nuk e shoh të arsyeshme të tërhiqet ngase këtij Komiteti i nevojitet si anëtar, është kontribuues dhe besoj që i jep shumë këtij Komiteti, andaj edhe i propozoj që deri në mbledhjen e ardhshme të shqyrtohet mundësia që mos të jap dorëheqje, gjithnjë nëse ekziston mundësia.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, ju falënderoj edhe një herë të gjithëve, unë kam jap dorëheqje të parevokueshme edhe pse për këtë Komitet do të kontribuoj sërish mirëpo gjërat janë kështu si janë andaj për fund ju faleminderit të gjithëve.

Nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11.05'

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0009931/19

Podujevë,

05 shkurt 2019

Kryesuesi i Komitetit

Xhafer Ademi